



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Datë: 23.04.2026

PROCES-VERBAL

Këshilli Bashkaik Kamëz i mbledhur sot, në dt. 23.04.2026, në orën 16:00, në mbledhjen e radhës të muajit Prill 2026 në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kamëz. Të pranishëm në mbledhje janë 23 anëtar të Këshillit, përfaqësues nga administrata e Bashkisë. Mbledhja mbahet nga Kryetari i Këshilli Bashkiak z.Hysen Koldashi i cili hap mbledhjen me fjalët përshëndetëse.

Kr. Hysen Koldashi: Sipas njoftimit nga sekretaria mbi bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në rregulloren e Këshillit Bashkiak 33 datë 21.03.2024; Neni 81 pika 1, sot zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak.

Kr. Hysen Koldashi: Përpara se ta fillojmë, i kalojmë fjalën sekretarisë për prezencën. Ju lutem, sekretaria.

- Sekretaria konfirmon pjesëmarrjen e Këshilltarëve.

Kr. Hysen Koldashi:Paraprakisht hedhim në votim proces-verbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. E hedhim në votim. 23 vota-Pro, 0 vota -Kundra, 0 vota -Abstenim.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit! Atëherë, me rendin e ditës jeni njohur, e keni të printuar në tavolinën tuaj, si më poshtë vijon:

1. Projekt-Vendim Nr.24 datë 17.04.2026 për: “Miratimin e planit vendor për rininë 2026-2030”.
2. Projekt-Vendim Nr.25 datë 17.04.2026 për: “Miratimin e hartës së përditësuar të kufijve ndarës administrative-territoriale dhe fshatrave brenda territorit të Bashkisë Kamëz”.
3. Projekt-Vendim Nr.27 datë 22.04.2026 për: “Miratimin e kërkesës për rritjen e kapaciteteve të shërbimeve sociale dhe terapeutike nga Qendra “Doors of Life Albania”, për Bashkinë Kamëz”.
4. Projekt-Vendim Nr.28 datë 23.04.2026 për: “Një ndryshim në vkb nr.74 datë 26.07.2024, “Miratimin e krijimit të ansambllit të valleve “Artan Cuku”, krijimit të formacionit orkestral dhe pagesës së tyre nëpërmjet honorareve”.
5. Projekt-Vendim Nr.26 datë 17.04.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.
6. Projekt-Vendim Nr.29 datë 23.04.2026 për: “Deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të Këshilltares znj.Xhensila Durrsi”.
7. Ndryshim emërtimi rrugësh në territorin e Bashkisë Kamëz.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

8. Informacion Këshillit Bashkiak, “Për monitorimin e Planit Social 2024-2026”.
9. Informacion Këshillit Bashkiak, “Për raportin përfundimtar të auditimit, “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit, të KLSH .
10. Të ndryshme.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime: S’ka. E hedhim në votim rendin e ditës. 23-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimet me radhë sipas rendit të ditës. Kemi projektvendim nr. Nr.24 datë 17.04.2026 për: “Miratimin e planit vendor për rininë 2026-2030”. Relacionet shpjeguese për të gjithë projektvendimet i keni para në tavolinë, ju kanë ardhur në e-mail dhe do procedojmë si çdo herë tjetër, kush ka pyetje konkrete për drejtorinë, për grupin e punës për projektvendimin të cilët sapo lexuam. Pyetje, paqartësi?

Kr. Hysen Koldashi: Fjala për këshilltarin Halilaj.

Alfred Halilaj Këshilltar: Përshëndetje të gjithëve. Duke falënderuar për punën, kam një pyetje konkrete për dr. A mendoni se në Pallatin e Kulturës duhet të ketë një hapësirë më të madhe për rininë dhe a është planifikuar sipas jush një zyrë më vete për ta, apo jo?

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Kush është përgjegjësi, të japi përgjigje, po fjala për ju?

Peme Marku Dr. i Integritit në BE. Përshëndetje i nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak. Për sa i përket pyetjes, në fakt plani ka parashikuar sallën e rinisë, e cila është aktiv dhe funksionon, por gjithashtu është edhe qendra rinore, një hapësirë e cila është e dedikuar për të rinjtë, së bashku me bibliotekën. këto janë ambiente që janë pranë Pallatit të Kulturës të cilat i përkasin rinisë.

Kr. Hysen Koldashi: Po. Pyetje tjetër.

Alfred Halilaj Këshilltar: Po. Faleminderit. A është e mundur që te ky pallat, që një organizatë joqeveritare, kushdo qoftë ajo, të kërkojë dhe të ketë zyrat pranë Pallatit të Kulturës, sigurisht që specifikisht për rininë, pra për çështjet e rinisë? A keni ju mundësi ta bëni këtë? Se në dijeninë time ka pasur disa kërkesa dhe nuk janë miratuar dhe për këtë po pyes.

Kr. Hysen Koldashi: Kjo nuk është pyetje për drejtoreshën në fjalë. Kjo është një pyetje tjetër që ka të bëjë me organizimin e Pallatit të Kulturës dhe nëse nuk ka një përgjigje nga Bashkia, atëherë do ta marrim si përgjigje nga Sekretaria dhe do t'ju kthejmë përgjigje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime: S'ka! E hedhim në votim! 23 vota-Pro; 0 vota-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë më pv. nr. 25 datë 17.04.2026, "Miratimin e hartës së përditësuar të kufijve ndarës administrative-territoriale dhe fshatrave brenda territorit të Bashkisë Kamëz". Kush e do fjalën për pyetje-diskutime- apo paqartësi? Pra, këshilltar, kush ka pyetje konkrete?

Alfred Halilaj Këshilltar: Faleminderit. Kryetar, kam disa pyetje tërësisht konkrete. 1. Cilat janë kriteret mbi të cilat është bërë ndarja qytet-fshat? 2. A ndikon kjo ndarje në qytet-fshat, në sistemin e taksimit brenda qytetit? 3. A ndikon në vlerën e pronës ndarja qytet-fshat? Dhe e fundit, edhe pak për hularitet: Ndërkohë që në Paskuqan ndërtohen pallate, ne vazhdojmë ta quajmë fshat?

Kr. Hysen Koldashi: Po, nga drejtoria.

Eva Lala Përgj. Dr Urbanistikës: Përshëndetje, Kryetar, Ju të nderuar anëtarë të Këshillit. Për sa i përket përgjigjes së parë, në lidhje me qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative, është një ligji nr.115 i vitit 2014, për ndarjen administrative territoriale të vendit, i cili ka në përbërje edhe qytetet, edhe fshatrat, edhe njësive administrative. Dhe harta përkatëse për sa i përket relacionit është e ndarë sipas këtij ligji.

Atëherë, në relacion është e shpjeguar që në bashkëpunim me ASIG-un, kjo hartë është përditësuar dhe do të përdoret për sistemin e adresave. Dhe e dyta, për sa i përket taksimit, është një çështje tjetër që unë nuk jam pjesë e taksave. Unë jam pjesë e urbanistikës, në momentin që mund të vijë një person i taksave, mund të kthejë përgjigjen përkatëse. Ndërsa për sa i përket pyetjes së tretë, për pjesën e ndërtimeve në lidhje me qytetet dhe fshatrat, apo jo?

Ndërhyn Këshilltari Halilaj.

Alfred Halilaj Këshilltar: Pra, çfarë ndodh në sistemin e pronësisë, sepse e gjithë loja është që dallimi fshat-qytet përcakton edhe mënyrën e investimit dhe të zhvillimit të zonës. Pra, që do të thotë që nëse ti e përcakton si fshat, vlera e pronës në atë pjesë, dhe sigurisht dhe gjithë sistemi i taksimit nga pas, ndryshon, pra bëhet më e ulët. Ndërsa kur përcaktohet si zonë urbane, patjetër që edhe sistemi i taksimit, por edhe vlera e pronës do të jetë më e lartë. Pra, juve e keni bërë këtë lloj përllogaritjeje? A ka dallim, apo jo?

Kr. Hysen Koldashi: Do t'ia jap unë përgjigjen Këshilltarit. Pra, kjo pyetje nuk qëndron aq në kontekstin të projektvendimit që po kalojmë. Projektvendimi ka të bëjë me ndarjen territoriale për adresarin. Janë çështje të ndryshme këto. Pra, nuk ka të bëjë me projektvendimin. Pra, ky projektvendim ka të bëjë thjesht dhe vetëm me adresarin, me adresën që ka në territorin e Bashkisë Kamëz dhe s'ka të bëjë me asgjë tjetër përveç kësaj gjëje. Dhe nëse ju e keni këtë shqetësim, ato



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

të tre pyetjet e tjera, se dy pyetjet i more përgjigjet ne mund të marrim si shënim. Drejtoria përkatëse do dali me shkresë apo prezentë në mbledhjen e ardhshme të bëjë shpjegimet e duhura shtruese. Pyetje tjetër?

Kërkon fjalën N/Kr Këshillit Shehu.

Munir Shehu Nkr Këshillit: Në bazë të atij ligji që ke, a kemi ndryshime, kufinjsh të zonave administrative? Psh. Njs Adm. Bathore, Paskuqan etc.

Eva Lala Përgj. DR Urbanistikës: Jo, s'ka ndryshime. Është thjesht përditësim dhe nuk ka ndryshime, prandaj e përmenda që në fillim.

Kr. Hysen Koldashi: Është i njëjtë. Thjesht i duhet për pjesën e sistemit të adresarit.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime: S'ka! E hedhim në votim. 22 vota-Pro; 1 votë-Kundër, 0 vota- Abstenim. Miratohet.

Alfred Halilaj Këshilltar: Sepse nga fakte të vogla, ndërtohen teori të mëdha. Pra ndërtohet përditë dhe ndryshohen, çdo ditë ndryshohen destinacionet e zonave. Unë bëra pyetjen që nga ky fakt i vogël, banal, të mos implikojë në të ardhmen problemet e zonës.

Kr. Hysen Koldashi: Kam edhe një këshillë. Kur ndërtohet, është absolutisht shumë mirë, se ndërtohet në vende ku ka interes privati. Nëse s'ka interes, nuk bën ndërtim, ti s'bën një biznes asnjëherë nëse nuk e shikon që ti do kesh të ardhura nga biznesi që bën.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin nr. Nr.27 datë 22.04.2026 për: "Miratimin e kërkesës për rritjen e kapaciteteve të shërbimeve sociale dhe terapeutike nga Qendra "Doors of Life Albania", për Bashkinë Kamëz".

Marime Vladi Dr. NE - Përhëndetje të gjithëve. Organizata ka sjellë një shkresë që është bazuar në planin social vendor 2024-2026, dhe vjen nevoja për zgjerim të shërbimit në gjithë territorin. Duke qenë që organizata dëshiron t'i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me një projekt, kërkon që në parim të miratohet si kërkesë në Këshillin Bashkiak, pastaj t'i drejtohet me një projekt Ministrisë për fondin social.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime nga Këshilltarët?

Alfred Halilaj Këshilltar: Po, kisha unë, nëse munde. Ne vetëm thjesht japim miratimin që projekti të shkojë pranë Ministrisë, apo ne na duhet të japim një fond?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Marime Vladi Dr.NE Jo. Ne e dorëzojmë kërkesën në parim për t'ju drejtuar Ministrisë si organizatë pa buxhet të Bashkisë. Ideja, ajo është mbështetje të planit social vendor 2024-2026, që është për rritjen e kapaciteteve për shërbime sociale në territorin e Bashkisë Kamëz.

Alfred Halilaj Këshilltar: Në qoftë se do ta shtyj unë pak argumentin, nëse a është e mundur që ne, pra edhe Bashkia, të kontribuojë në këtë projekt?

Marime Vladi Dr.NE Në këtë projekt është financimi vetëm nga Ministria dhe nga organizata, nuk është nga Bashkia.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka! E hedhim në votim. 23 vota-Pro; 0 votë-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Projektvendim nr. 28, datë 23.04.2026, "Një ndryshim në vkb nr.74 datë 26.07.2024, "Miratimin e krijimit të ansamblit të valleve "Artan Cuku", krijimit të formacionit orkestral dhe pagesës së tyre nëpërmjet honorareve".

Kr. Hysen Koldashi: Ta shpjegoj shumë shkurt. Ka të bëjë me ndryshime thjesht me rritjen e honorarit për individ. Thjesht është, e kemi miratuar ne dhe e kemi rritur honorarin nga 50 e kemi bërë 100 për ata që do marrin pjesë në aktivitete. Nuk ka asnjë lloj ndryshimi. Pyetje?

Alfred Halilaj Këshilltar: Kur do të çlirohet Pallati i Kulturës nga të qenit një qendër tregtare? Kur juve, si drejtoreshë, do hiqni ato biznese që janë aty, që kanë nxënë hapësirat publike dhe përdorin në mënyrë të padrejtë hapësira që duhet t'i takonin qytetarëve, të rinjve?

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit për pyetjen. Jeni jashtë kontekstit të temës i nderuar koleg. Por do ta them unë, do të çlirohet shumë shpejt brenda këtij viti kalendarik, sapo të bëhet qendra e Kamzës, të cilën do ta bëhet në qendrën më të mirë në Republikën e Shqipërisë, me të gjitha asetet e nevojshme etj.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka. E hedhim në votim. 23 vota-Pro; 0 vota-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Projektvendimi i radhës nr. 26 datë 17.04.2026, "Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike".

Munir Shehu Nkr Këshillit: A ka ndonjë ligj që do të rrisë të ardhurat për ndihmat ekonomike?

Marime Vladi Dr.NE- Për momentin asgjë, ne i kemi të përcaktuara në kritere të cilat ua kemi të miratura me vkb.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka! E hedhim në votim! 23 vota-Pro; 0 vota-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me pikën e radhës. Kemi ndryshim rrugësh në territorin e Bashkisë së Kamzës. Ka të bëjë me dy rrugë. Kemi një rrugë pa emër dhe është propozuar nga instancat përkatëse në "Xhafer Bakalli". Është në lagjen administrative nr.1. Është segment rruge. Nëse ka kush paqartësi, mund ta shpjegojmë, rrugë pa dalje.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime nga Këshilltarët. Fjala për ju.

Alfred Halilaj Këshilltar: Jo, thjesht dua ta vlerësoj figurën, se ndoshta shumë kush nuk e njeh Xhaferin, të ndjerin. Ishte një qytetar i nderuar i këtij qyteti, ka qenë pjesë e Bashkisë dhe ka kontribuar në vite, kështu që e meriton ta ketë emërtimin e kësaj rruge.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit Ju për votën tuaj personale dhe të grupit. Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka! E hedhim në votim. 23 vota-Pro; 0 vota-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Rruga tjetër është: Aron Duraku. Pra, nga Aron Duraku do bëhet Harku i Triumfit. Pra, është një pjesë e rrugës. Është një hark që është gjysmë hëne e gjitha dhe një segment i kësaj rruge që ka të bëjë më këtë të marrë emërtimin e rrugës "Aron Duraku" dhe pjesa tjetër "Harku i Triumfit".

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka! E hedhim në votim. 23 vota-Pro; 0 vota-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Projekt-Vendim Nr.29 datë 23.04.2026 për: "Deklarimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të Këshilltares znj. Xhensila Durrsi". Znj. Xhensila Durrsi i ka mbaruar mandati si këshilltare, nuk është paraqitur më shumë se 6 muaj rresht në mbledhje siç e parashikon ligji, Është mbledhur Komisioni i Mandateve ka bërë verifikimet e duhura dhe ka bërë projektvendimin, të cilin e ka sjellë në Këshill për miratim.

Dritan Bresa Këshilltar: Pse duhet ta votojmë?

Kr. Hysen Koldashi: Ja ta shpjegojmë pse duhet të hedhim në votim. Pra, në momentin kur zonja ose zonjusha ose Antar/e Këshilli Bashkiak, i jep dorëheqje me vullnetin e saj, atëherë Këshilli Bashkiak vetëm njoftohet. Në këtë rast nuk ka dhënë dorëheqje, se është jashtë shtetit, është jashtë territorit të Shqipërisë. Dhe në pamundësi për të bërë dorëheqje direkte, ne jemi detyruar, sepse ka shkelur afatet kohore në më shumë se 6 mbledhje radhazi të Këshillit Bashkiak. Duhet ta kemi të qartë dhe të theksojmë e këtë, duhet të jetë 6 muaj, se mund të bëjmë mbledhje të Këshillit Bashkiak edhe jashtë radhës. Jo 6 mbledhje, por 6 muaj. Dhe jemi detyruar, jemi para faktit që zonjën anëtare të këshillit ta votojmë. Pyetje diskutime, fjala për ju.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Alfred Halilaj Këshilltar: Xhensila duhet të ishte këtu, të dëgjonim fjalën e saj.

Kr. Hysen Koldashi: Me gjithë dashamirësinë e profesorit dhe unë i bashkohem profesorit edhe për atë çfarë paraqet nga Këshilli Bashkiak, po jemi në kushtet e pamundësisë të mos e votojmë, anëtaria e Këshillit është jashtë shteti.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Pyetje-Diskutime të tjera: S'ka! E hedhim në votim; 22 vota-Pro; 1 votë-Kundër, 0 vota-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Kemi informacion për Këshillin Bashkiak, për monitorimin e planit social 2024-2026. Do të pyesim sa më konkretisht, që nëse ka pyetje. Nuk i hedhim në votim. Që janë të gjitha objektivat dhe aktivitetet që kanë qenë parashikuar tek ky plan, bashkëlidhur është edhe informacioni për të gjithë aktivitetet që janë realizuar deri më tani.

Kr. Hysen Koldashi: Kemi pika 9 informacion Këshilli Bashkiak për raportin përfundimtar të auditimit, "Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit të KLSH-së".

Marime Vladi Dr.NE dhe CËSHTJEVE SOCIALE: Po, rekomandimet që janë lënë nga KLSH-ja për të moshuarit është ngritur grupi i punës dhe është bërë një plan veprimi për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të lëna.

Kr. Hysen Koldashi: Po, ka kush ndonjë pyetje, një paqartësi? z. Halilaj e shikoj që do të marrë fjalën. Po.

Alfred Halilaj Këshilltar: A mendoni se do ti realizoni rekomandimet e lëna nga KLSH-ja?

Marime Vladi Dr.NE dhe CËSHTJEVE SOCIALE: Për sa i përket rekomandimeve të lëna, mendoj që janë të realizueshme, sepse ne edhe para se bënte verifikime, kontrollin KLSH-ja tek ne, ne kemi bërë identifikimin e të gjithë të moshuarve të vetmuar që janë brenda territorit të Bashkisë së Kamzës. Dhe jeni ju ata që kemi miratuar kriteret dhe i trajtojmë çdo muaj me 50 mijë lekë të vjetra. Dhe po ashtu janë edhe pjesa e burimeve njerëzore, që bashkë me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore do të shikojmë që në bazë të ligjit që thotë për sektorin që duhet të jetë i shtrirë në gjithë territorin e Bashkisë së Kamzës, do shikohet mundësia për burime njerëzore në vazhdimësi, që të jenë në bazë të popullsisë që ka territori i Bashkisë së Kamzës.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Atëherë kalojmë te pika e fundit, tek ndryshmet. Po, fjala për ju këshilltar?

Kr. Hysen Koldashi: Po, zonjusha Elezaj?

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Atëherë, duke qenë se kemi drejtoresën e Pallatit të Kulturës, do të doja t'i bëja një kërkesë për informacion në lidhje me një nga projektet që Pallati i Kulturës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

bashkë me Drejtorinë e Integritimit ka vendosur tek plani rinor-vendor 2026-2030. Ka të bëjë me festivalin "Folk Youth", që është parashikuar, siç thashë, për të qenë pjesë e aktiviteteve. Do kërkoja një informacion të shkurtër me shkrim nga drejtoria në lidhje me hapat konkretë që janë planifikuar për realizimin e festivalit, afatet e zbatimit dhe strukturat përgjegjëse, mbështetjen logjistike dhe financiare, mënyrën e koordinimit me grupet rinore dhe institucionet partnere, dhe planin e vazhdimësisë së festivalit si aktivitet i përvitshëm. Në qoftë se nuk realizohet për këtë vit, do të doja të dija se si do jenë hapat për realizimin në vitet e tjera. Dhe në qoftë se nuk realizohet këtë vit, cilat janë arsyet?

Kr. Hysen Koldashi: Pyetjet që i keni transmetuar këtu do t'ia jepni sekretarisë, t'i shënojë të gjitha, dhe brenda afateve kohore ligjore absolutisht do të kthehet përgjigja zyrtare. Faleminderit.

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Një diçka tjetër. Doja vetëm t'i thoja diçka z. Alfred, për sa i përket informacionit për monitorimin e planit social, nuk e di në qoftë se e ju e keni vënë re një automjet që kalon nëpër Bashkinë e Kamëz që shkruan "AU For Social Care", është një nga risitë që ka sjellur Drejtoria e Mbrojtjes Sociale. Është një automjet i dedikuar për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë nëpër këto qendra sociale të trajtimit të këtyre personave, i cili i ndihmon ato për të marrë trajtimin e duhur. Në një trajnim që ishim me bashki të tjera, trajnerja na tha që jemi bashkia e parë që ka vendosur në dispozicion një automjet të tillë për këta persona, kështu që ndoshta në momentin që personat dhe drejtoria përgjegjëse vijjnë për të na thënë një informacion të tillë, do ishte mirë që t'i vlerësonim pak për punën që bëjnë.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit, Zj Elezaj, për këtë mund të ju drejtoheni të gjithëve.

Kr. Hysen Koldashi: Znj. Merita, fjalë për ju.

Merita Prenga Këshilltare: E para, unë jam gjithmonë pro emërimit të rrugëve për njerëzit të cilët kanë kontribuar për vendin e tyre. Si mësuese e letërsisë, pa diskutim që Remarkun unë e vlerësoj shumë, jo unë, por e vlerëson gjithë bota. Por në rast se ajo zonë në të cilën jetojmë e njohim mirë veprën letrare të Remarkut, "Harku i Triumfit", a mund ta pranojnë vendosjen e emërimit të një rruge. E dyta, unë e kam dërguar në sekretari një informacion, një kërkesë, në rast se uroj që të merret patjetër parasysh, se nga Bashkia Kamëz janë vlerësuar njerëzit vërtetë që kanë kontribuar për komunitetin, për vendin. Është një kolege im që ka dalë në pension, Fatmir Gjestila, jo vetëm arsimtari i nderuar, por dhe një shkrimtar shumë i respektuar për të vegjlit dhe për të rriturit. Shpresoj që vërtetë të marrë atë që kërkon dhe meriton, të shpallet "Qytetar Nderi", i qytetit tonë.

Kr. Hysen Koldashi: Sa më shpejt që të mundem, nuk mund t'ia jap afatet kohore, sepse nëse do t'ia jap afatet kohore, do themi pastaj se pse s'i bëjmë tani dhe pse i bëjmë më vonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë, duke falënderuar gjithë këshilltarët për kontributin tuaj, ju falënderojmë për gjithçka. Mbledhja deklarohet e mbyllur. Mbledhja e radhës njoftohet nga sekretaria.

SEKRETAR

Nexhmije TOPI